



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 43

Tiranë – E enjte, 16 mars 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 146, datë 13.3.2023	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria “SUNPRO” sh.p.k..... 4763
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 13.3.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i linjës 110 kV Unaza e Tiranës”..... 4765
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 148, datë 13.3.2023	Për kalimin të Bashkia Durrës të njësive individuale të banimit..... 4767
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 149, datë 13.3.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 276, datë 16.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të autoritetit rrugor shqiptar”, të ndryshuar..... 4767
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 13.3.2023	Për miratimin e marrëveshjes me shkëmbim notash për ndryshimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për përfshirjen e ndërsjellë të vizës hyrëse për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të shërbimit/speciale, nënshkruar më 13 prill 2015..... 4775
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 13.3.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 45, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ish- institucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”.. 4777
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 154, datë 13.3.2023	Për shpalljen e habitatit të tulipanit shqiptar “Monument natyror”.... 4787

Vendim i Gjykatës Kushtetuese
nr. 3, datë 7.2.2023

Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-771 (142), datë 31.3.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....

4790

Vendim i Gjykatës Kushtetuese
nr. 4, datë 8.2.2023

Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 78, datë 4.3.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; nr. 55, datë 29.7.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 00-2021-1923, datë 2.12.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimin e pikës 7, seksioni B, kreu X, të vendimit nr. 75, datë 23.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....

4795



VENDIM

Nr. 146, datë 13.3.2023

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË
CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE EOLIKE DHE
VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK
ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË
TRAGJAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE
ORIKUM, QARKU VLORË, NGA
SHOQËRIA “SUNPRO” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria “SUNPRO” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) emri i aplikuesit: shoqëria “SUNPRO” sh.p.k.;

b) numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: L81906033I;

c) tipi i centralit: eolik;

ç) kapaciteti i instaluar: 3 mw;

d) afati i pritshëm i vënies në punë: Koha për marrjen e lejes së ndërtimit, ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve;

dh) vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë;

e) afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vite nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) koordinatat e tokës sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ose Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) Shoqërisë “SUNPRO”, sh.p.k., i lind e drejta të krijojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit një

shoqëri për qëllime të veçanta, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit eolik;

gj) e drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, me kapacitet të instaluar 3 MW, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, e dhënë sipas këtyre rregullave, si dhe më shumë se 10% e kuotave të shoqërisë për qëllime të veçanta mund të transferohet te një subjekt i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

h) Shoqëria “SUNPRO”, sh.p.k., ose shoqëria për qëllime të veçanta ka detyrimin, që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore ose institucioneve të tjera të autorizuar informacion mbi ecurinë e ndërtimit të centralit eolik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë “SUNPRO” sh.p.k., ose shoqërisë për qëllime të veçanta dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “SUNPRO” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Faqe | 4763

**VENDIM****Nr. 147, datë 13.3.2023****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI
“NDËRTIMI I LINJËS 110 kV UNAZA E
TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i linjës 110 kV Unaza e Tiranës”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST).

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, “ullishte” dhe “pemëtore”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 378 770.21 (një milion e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë pikë njëzet e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 378 770.21 (një milion e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë pikë njëzet e një) lekësh, përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST).

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST).

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST).

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST).

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë, në favor të shtetit dhe në përgjegjësi administrimi të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit dhe në përgjegjësi administrimi të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST), Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURISË TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“NDËRTIMI I LINJËS 110 kV UNAZA E TIRANËS”

NR.Rendor	NR.Shytle	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE					VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM					Shënime	
		Emri	Atësia	Mbiemri	ose Fshati Qyteti	Z. Kadastrale	Nr. pasurisë	Lloji pasurisë	Specifika të "Are" (m ²)	Specifika (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	VLERA TOTALE (lekë)			
1	1	Myrreza	Shaban	Gjasha	Petrelë	2947	371/11	Are	8000	162.05	470	76,163.50	76,163.50		Konfirmuar nga ASHK-ja	
2	1	Myrreza	Shaban	Gjasha	Petrelë	2947	371/11	Are	8000	139.90	470	65,753.00	65,753.00		Konfirmuar nga ASHK-ja	
3	8	Skerender	Abdyll	Tujani	Mjull Bathore	2704	381/154	Ullishie	4675	254.08	523	132,883.84	132,883.84		Konfirmuar nga ASHK-ja	
4	9	Petrri	Anf	Osmi	Mjull Bathore	2704	381/173	Ullishie	16000	190.44	523	99,600.12	99,600.12		Konfirmuar nga ASHK-ja	
5	10	Xhuljo	Qemal	Husha	Mjull Bathore	2704	509/7	Ullishie	3500	94.67	523	49,512.41	49,512.41		Konfirmuar nga ASHK-ja	
6	11	Suela, Mimoza	Zyhdi, Jahja	Husha, Husha	Mjull Bathore	2704	508/2	Ullishie	4000	114.92	523	60,103.16	60,103.16		Konfirmuar nga ASHK-ja	
7	13	Suela, Mimoza	Zyhdi, Jahja	Husha, Husha	Mjull Bathore	2704	532/46	Are	445	296.87	523	155,263.01	155,263.01		Konfirmuar nga ASHK-ja	
8	15	Zelije, Dilaver Petrri, Ismail Duhije, Shyqiri Zejnepë, Kismete Adriana Enkel		Bathorja Bathorja Bathorja Bathorja Metalla Bathorja Maçi Sadiku Bathorja Bathorja	Laudër	2529	363/4	Are	4625	168.74	523	88,251.02	88,251.02		Konfirmuar nga ASHK-ja	
9	16	Sali	Ramazan	Shalqizi	Laudër	2529	716/2	Pernitore	1230	102.21	523	53,455.83	53,455.83		Konfirmuar nga ASHK-ja	
10	18	Bajram		Shkalla	Farkë e Madhe	1604	383/1			86.12	448	38,581.76	38,581.76		Konfirmuar nga ASHK-ja	
11	19	Demir	Tahir	Plaku	Farkë e Vogël	1605	212/43	Are	1700	116.42	448	52,156.16	52,156.16		Konfirmuar nga ASHK-ja	
12	21	Bashkim, Dalip, Hamide, Mehmet, Mustafa, Myzejen, Qanie	Mersin Mersin Mersin Mersin Mersin Mersin	Balla, Balla, Balla Demiri, Balla, Balla, Demetija(Balla) Spahiu(Balla)	Farkë e Vogël	1605	225/23	Are	18000	62.29	448	27,905.92	27,905.92		Konfirmuar nga ASHK-ja	
13	22	Dashamir	Misir	Balla	Farkë e Vogël	1605	222/20	Are	3000	75.3	448	33,734.40	33,734.40		Konfirmuar nga ASHK-ja	
14	24	Dashamir	Riza	Karpeni	Farkë e Vogël	1605	164/9	Are	1000	102.21	448	45,790.08	45,790.08		Konfirmuar nga ASHK-ja	
15	25	Sali		Karpeni	Farkë e Madhe	1605	25/54	Are	1000	77.09	448	34,536.32	34,536.32		Konfirmuar nga ASHK-ja	
16	26	Haxhi	Bajram	Karpeni	Farkë e Madhe	1605	25/3	Are	9440	145.2	448	65,049.60	65,049.60		Konfirmuar nga ASHK-ja	
17	27	Resmije, Marigena, Anisa, Florenc	Hazem, Rifat, Rifat, Rifat	Qepu, Larmaj, Qepu, Qepu	Farkë e Madhe	1605	18/2	Ullishie	2756	102.21	448	45,790.08	45,790.08		Konfirmuar nga ASHK-ja	
18	28	Mynyr	Mustafa	Hafuza	Farkë e Vogël	1605	3/18	Are	6800	177.69	448	79,605.12	79,605.12		Konfirmuar nga ASHK-ja	
19	29	Shefqet	Maliq	Gollaku	Farkë e Madhe	1604	401/14	Are	1750	175.03	448	78,413.44	78,413.44		Konfirmuar nga ASHK-ja	
20	30	Eduard, Zeliqe, Agron	Tahir, Hysen, Tahir	Tresa, Tresa, Tresa	Farkë e Madhe	3976	333/119	Are	8569.5	112.57	448	50,431.36	50,431.36		Konfirmuar nga ASHK-ja	
21	33	Rihun, Arben, Alked, Saimir		Shkreta, Shkreta, Shkreta, Shkreta	Farkë e Madhe	3976	184/4	Are	7000	102.21	448	45,790.08	45,790.08		Konfirmuar nga ASHK-ja	
VLERA TOTALE													1,378,770.21			



VENDIM
Nr. 148, datë 13.3.2023

**PËR KALIMIN TE BASHKIA Durrës
TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te Bashkia Durrës të 10 (dhjetë) njësie individuale të banimit, sipas listës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA E OBJEKTEVE, PAKETA B – BASHKIA Durrës

Nr.	ID	Lista	Emër Mbiemër	Tipologjia	Sip. (m ²)	Bashkia	Njësia Administrative	Vlera e objektit (lek)	Vlera e mbikëqyrjes (lek)	Vlera e kolaudimit (lek)
1	192	L.1	Xhemali Sali Tola	3+1	105.10	Durrës	Manzë	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
2	4	L.1	Gentjana Myslim Gega	3+1	105.10	Durrës	Ishëm	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
3	26	L.1	Dervish Osman Visha	3+1	105.10	Durrës	Ishëm	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
4	51	L.1	Veseli Hasan Vela	3+1	105.10	Durrës	Ishëm	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
5	67	L.1	Kujtim Selim Gega	3+1	105.10	Durrës	Ishëm	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
6	77	L.1	Indrit Mustafa Alushi	1+1	70.00	Durrës	Ishëm	2,100,000.00	18,601.95	1,897.80
7	113	L.1	Urim Rushit Salija	3+1	105.10	Durrës	Ishëm	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
8	265	L.1	Behar Xheladin Piza	2+1	80.00	Durrës	Ishëm	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
9	266	L.1	Flamur Muhareem Mullahi	2+1	80.00	Durrës	Ishëm	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
10	280	L.1	Hashi Hamid Likmeta	3+1	105.10	Durrës	Ishëm	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80

VENDIM
Nr. 149, datë 13.3.2023

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 276, DATË 16.5.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E MËNYRËS SË
ORGANIZIMIT, TË STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE STATUTIT TË
AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009, “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 276, datë 16.5.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun IV, “Struktura dhe organika”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikat 2 dhe 6, emërtimi “Drejtoria e Rajonit Qendror (Tiranë)” zëvendësohet me “Drejtoria e Rajonit Qendër Perëndim (Tiranë)”.

b) Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Struktura e Drejtoria e Rajonit Qendër Lindje (Korçë) është sipas skemës 1/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

c) Pas pikës 8 shtohet pika 8/1, me këtë përmbajtje:

“8/1. Organika e Drejtoria e Rajonit Qendër Lindje (Korçë) është sipas skemës 2/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.



ç) Në pikën 9, togfjalëshi "... 166 veta" zëvendësohet me togfjalëshin "... 286 punonjës".

2. Skemat 1, 1/1, 1/2, 1/3, 2, 2/1, 2/2 dhe 2/3, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me skemat përkatëse me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Pas skemës 1/3, bashkëlidhur vendimit, shtohet skema 1/4, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Pas skemës 2/3, bashkëlidhur vendimit, shtohet skema 2/4, bashkëlidhur këtij vendimi.


II. Ngarkohet Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



KRYEMINISTËR
Edi Rama

SKEMA 1

STRUKTURA E AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR



SKEMA 1/1**STRUKTURA E DREJTORISË SË RAJONIT QENDËR PERËNDIM (TIRANË)**SKEMA 1/2**STRUKTURA E DREJTORISË SË RAJONIT VERIOR (SHKODËR)**

SKEMA 1/3**STRUKTURA E DREJTORISË SË RAJONIT JUGOR (GJIROKASTËR)**SKEMA 1/4**STRUKTURA E DREJTORISË SË RAJONIT QENDËR LINDJE (KORÇË)**



Skema 2

ORGANIKA E ZYRËS QENDRORE TË AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR

POZICIONI		KATEGORIA	NUMRI
1.	DREJTORI I PËRGJITHSHËM	II-a	1
	KOORDINATOR I RRJETIT TE KOORDINATOREVE KUNDER KORUPSIONIT	II-b	1
2.	DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE OPERACIONEVE		32
	DREJTOR	III-a	1
2.1	SEKTORI I HARTIMIT TË PROJEKTEVE TË BRENDSHME		10
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	9
2.2	SEKTORI I HARTIMIT TË PROJEKTEVE TË HUAJA		3
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
2.3	SEKTORI I PREVENTIVIT		4
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	3
2.4	SEKTORI I SIGURIMIT TË TOKËS		11
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	10
2.5	SEKTORI I MJEDIST DHE IMPAKTIT SOCIAL		3
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
3.	DREJTORIA E NDËRTIMIT DHE MIRËMBAJTJES		32
	ZEVENDESDREJTOR I PËRGJITHSHËM/DREJTOR	II-b	1
POZICIONI		KATEGORIA	NUMRI
3.1	SEKTORI I MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE TË HUAJA		3
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
3.2	SEKTORI I MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE TË BRENDSHME		7
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	6
3.3	SEKTORI I PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT (PPP)		3
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
3.4	SEKTORI I SIGURIMIT TË CILËSISË DHE DORËZIMIT		10
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	9
3.5	SEKTORI I MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE		8
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	7



4. DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE FINANCËS		9
DREJTOR	III-a	1
4.1 SEKTORI I FINANCËS		4
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	3
4.2 SEKTORI I PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT		4
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	3
5. DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME		22
DREJTOR	III-a	1
5.1 SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE		3
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	2
5.2 SEKTORI I ARKIVËS DHE PROTOKOLLIT		4
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-b	3
5.3 SEKTORI I SHËRBIMEVE		14
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST(SHËRBIME)	IV-a	1
TEKNIK I MESËM		1
PASTRUES		3
SHOFER		8
DREJTORIA JURIDKE DHE PËRPUTSHMËRISË SË		
6. STANDARTEVE		9
DREJTOR	III-a	1
6.1 SEKTORI JURIDIK DHE PËRPUTSHMËRISË		4
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	3
6.2 SEKTORI I PROKURIMEVE		4
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	3
8. SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHEM		3
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	2
8. SEKTORI I KOMUNIKIMIT		3
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	2
PUNONJËS GJITHSEJ		112



Skema 2/1

ORGANIKA E DREJTORISE SE RAJONIT QENDER PERENDIM (TIRANE)

	POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1	DREJTOR	III-b	1
2	SEKTORI I FINANCES DHE SHERBIMEVE MBESHTETESE		10
	PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-a	1
	SPECIALIST (Arkiv/Protokoll)	IV-b	1
	SPECIALIST (Jurist)	IV-b	2
	SPECIALIST (Ekonomist)	IV-b	1
	SPECIALIST (Financier)	IV-b	1
	SPECIALIST (Sherbime)	IV-b	2
	PASTRUES (Sanitare)		1
	SHOFER		1
3	SEKTORI I OPERACIONEVE		7
	PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-a	1
	SPECIALIST (Inxhinier Primar)	IV-b	6
4	SEKTORI I MIREMBAJTJES ESTETIKE		23
	PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-a	1
	PERGJEGJES GRUPI		2
	PUNETOR MIREMBAJTJE		20
	PUNONJËS GJITHSEJ		41

Skema 2/2

ORGANIKA E DREJTORISE SE RAJONIT VERIOR (SHKODER)

	POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
2	DREJTOR	III-b	1
2	SEKTORI I FINANCES DHE SHERBIMEVE MBESHTETESE		10
	PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-a	1
	SPECIALIST (Arkiv/Protokoll)	IV-b	1
	SPECIALIST (Jurist)	IV-b	2
	SPECIALIST (Ekonomist)	IV-b	1
	SPECIALIST (Financier)	IV-b	1
	SPECIALIST (Sherbime)	IV-b	2
	PASTRUES (Sanitare)		1
	SHOFER		1
3	SEKTORI I OPERACIONEVE		7
	PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-a	1
	SPECIALIST (Inxhinier Primar)	IV-b	6
4	SEKTORI I MIREMBAJTJES ESTETIKE		29
	PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-a	1
	PERGJEGJES GRUPI		2
	PUNETOR MIREMBAJTJE		26
	PUNONJËS GJITHSEJ		47



Skema 2/3

ORGANIKA E DREJTORISE SE RAJONIT JUGOR (GJIROKASTER)

	POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
3	DREJTOR	III-b	1
2	SEKTORI I FINANCES DHE SHERBIMEVE MBESHTETESE		10
	PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-a	1
	SPECIALIST (Arkiv/Protokoll)	IV-b	1
	SPECIALIST (Jurist)	IV-b	2
	SPECIALIST (Ekonomist)	IV-b	1
	SPECIALIST (Financier)	IV-b	1
	SPECIALIST (Sherbime)	IV-b	2
	PASTRUES (Sanitare)		1
	SHOFER		1
3	SEKTORI I OPERACIONEVE		7
	PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-a	1
	SPECIALIST (Inxhinier Primar)	IV-b	6
4	SEKTORI I MIREMBAJTJES ESTETIKE		23
	PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-a	1
	PERGJEGJES GRUPI		2
	PUNETOR MIREMBAJTJE		20
	PUNONJËS GJITHSEJ		41

Skema 2/4

ORGANIKA E DREJTORISE SE RAJONIT QENDER LINDJE (KORÇE)

	POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
4	DREJTOR	III-b	1
2	SEKTORI I FINANCES DHE SHERBIMEVE MBESHTETESE		10
	PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-a	1
	SPECIALIST (Arkiv/Protokoll)	IV-b	1
	SPECIALIST (Jurist)	IV-b	2
	SPECIALIST (Ekonomist)	IV-b	1
	SPECIALIST (Financier)	IV-b	1
	SPECIALIST (Sherbime)	IV-b	2
	PASTRUES (Sanitare)		1
	SHOFER		1
3	SEKTORI I OPERACIONEVE		7
	PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-a	1
	SPECIALIST (Inxhinier Primar)	IV-b	6
4	SEKTORI I MIREMBAJTJES ESTETIKE		27
	PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-a	1
	PERGJEGJES GRUPI		2
	PUNETOR MIREMBAJTJE		24
	PUNONJËS GJITHSEJ		45

**VENDIM****Nr. 151, datë 13.3.2023**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES ME
SHKËMBIM NOTASH PËR
NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE,
PËR PËRJASHTIMIN E NDËRSJELLË
TË VIZËS HYRËSE PËR MBAJTËSIT E
PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, TË
SHËRBIMIT/SPECIALE, NËNSHKRUAR
MË 13 PRILL 2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes me shkëmbim notash për ndryshimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për përjashtimin e ndërsjellë të vizës hyrëse për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të shërbimit/speciale, nënshkruar më 13 prill 2015, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

Nr: MOFAIC/ILW/2022/47664**Datë: 10.11.2022**

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Emirateve të Bashkuara Arabe i paraqet komplimentet e saj Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Abu Dhabi.

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet dy vendeve mike dhe dëshirës për të lehtësuar lëvizjen e qytetarëve ndërmjet dy vendeve në mënyrë që të nxisë zhvillimin e shkëmbimeve dypalëshe, duke marrë parasysh

rëndësinë e lehtësimit të procedurave të hyrjes për qytetarët e të dy vendeve. vendet që posedojnë pasaporta të zakonshme, dhe duke iu referuar një Marrëveshjeje ndërmjet Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për përjashtimin reciprok të vizave të hyrjes për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe speciale/shërbimi, nënshkruar më 13 prill, 2015, në Abu Dhabi.

Ministria dëshiron të informojë Ambasadën e nderuar për propozimin e Emirateve të Bashkuara Arabe për të përjashtuar mbajtësit e pasaportave të zakonshme të shtetasve të të dy vendeve nga procedurat e vizave të hyrjes midis dy vendeve dhe për të ndryshuar Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për përjashtimin reciprok të vizës së hyrjes për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe speciale/shërbimi, nënshkruar më 13 prill 2015, në Abu Dhabi, duke shtuar pasaportat e zakonshme në kategoritë e pasaportave të referuara në Marrëveshje, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 11, i cili përcakton se “Çdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje do të miratohet reciprokisht nga të dyja palët dhe do të bëhet me shkëmbimin e shënimeve zyrtare përmes rrugëve diplomatike. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi siç parashikohet në nenin 12 të kësaj Marrëveshjeje.”

Prandaj, amendamenti i propozuar i Marrëveshjes është si më poshtë vijon:

Ndryshimi i titullit të Marrëveshjes në: “Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për përjashtimin reciprok të vizës së hyrjes për mbajtësit e pasaportave të zakonshme, diplomatike dhe të veçanta/shërbimi.

Ndryshimi i nenit 1 si më poshtë vijon:

1. Pasaporta të përjashtuara për Emiratet e Bashkuara Arabe: të zakonshme, diplomatike dhe speciale.

2. Pasaporta të përjashtuara për Republikën e Shqipërisë: të zakonshme, diplomatike dhe të shërbimit.

Ndryshimi, kudo që përmenden pasaportat, të bëhen siç përmenden në paragrafin 1 dhe paragrafin 2 të nenit 1, duke shtuar pasaportat e



zakonshme në mënyrë që për to të zbatohen dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

Ndryshimi i paragrafit 2 dhe 3 i nenit 2 si më poshtë vijon:

Shtohen fjalët “brenda periudhës 180 ditore”, në fund të çdo paragrafi.

Kjo notë diplomatike dhe përgjigjja e notës diplomatike me miratimin e autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë do të bëhen një Marrëveshje amenduese e marrëveshjes së sipërpërmendur të nënshkruar më 13 prill 2015 në përputhje me përcaktimet e paragrafit 1 të nenit 11.

Kjo notë diplomatike dhe nota diplomatike e pranimit me përgjigje do të konsiderohen si një marrëveshje amenduese e Marrëveshjes dhe do të konsiderohen si një aneks i saj.

Ministria ka më tej nderin të kërkojë ndihmën e mirëfilltë të Ambasadës së nderuar për të informuar autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë për sa më sipër dhe për të dhënë një notë të ngjashme diplomatike, për të vazhduar me procedurat e kërkuara për prezantimin e ndryshimeve të dakorduara në përputhje me shkëmbimin e Notave Diplomatieke me procedurat e kërkuara në mënyrë kushtetuese në çdo vend për të ratifikuar ndryshimet dhe më pas për të përfunduar procedurat në përputhje me përcaktimet e nenit 12 të Marrëveshjes.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Emirateve të Bashkuara Arabe përfiton nga ky rast për t'i ripërtërirë Ambasadës së nderuar të Republikës së Shqipërisë në Abu Dhabi, garancitë e konsideratës më të lartë.

Drejtuar: Ambasadës së Republikës së Shqipërisë – Abu Dhabi

Nr. _____

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Republikës së Shqipërisë i paraqet komplimentet e saj Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe referuar Notës Verbale të Asaj Ministrie nr. MOFAIC/ILW/2022/47664, datë 10 nëntor 2022, ka nderin të komunikojë si më poshtë:

“Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet dy vendeve mike dhe dëshirës
Faqe| 4776

për të lehtësuar lëvizjen e qytetarëve ndërmjet dy vendeve në mënyrë që të nxisë zhvillimin e shkëmbimeve dypalëshe, duke marrë parasysh rëndësinë e lehtësimit të procedurave të hyrjes për qytetarët e të dy vendeve. vendet që posedojnë pasaporta të zakonshme, dhe duke iu referuar një Marrëveshjeje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe për përjashtimin reciprok të vizave të hyrjes për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe speciale/shërbimi, nënshkruar më 13 prill 2015, në Abu Dhabi.

Ministria dëshiron të informojë Ambasadën e nderuar për propozimin e Emirateve të Bashkuara Arabe për të përjashtuar mbajtësit e pasaportave të zakonshme të shtetasve të të dy vendeve nga procedurat e vizave të hyrjes midis dy vendeve dhe për të ndryshuar Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe për përjashtimin reciprok të vizës së hyrjes për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe speciale/shërbimi, nënshkruar më 13 prill 2015, në Abu Dhabi, duke shtuar pasaportat e zakonshme në kategoritë e pasaportave të referuara në Marrëveshje, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 11, i cili përcakton se “Çdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje do të miratohet reciprokisht nga të dyja palët dhe do të bëhet me shkëmbimin e shënimeve zyrtare përmes rrugëve diplomatike. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi siç parashikohet në nenin 12 të kësaj Marrëveshjeje.”

Prandaj, amendamentet e dakorduara të Marrëveshjes janë si më poshtë vijon:

Ndryshimi i titullit të Marrëveshjes në: “Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe për përjashtimin reciprok të vizës së hyrjes për mbajtësit e pasaportave të zakonshme, diplomatike dhe të veçanta/shërbimi.

Ndryshimi i nenit 1 si më poshtë vijon:

1. Pasaporta të përjashtuara për Republikën e Shqipërisë: të zakonshme, diplomatike dhe të shërbimit.

2. Pasaporta të përjashtuara për Emiratet e Bashkuara Arabe: të zakonshme, diplomatike dhe speciale.

Ndryshimi, kudo që përmenden pasaportat, të bëhet siç përmenden në paragrafin 1 dhe paragrafin



2 të nenit 1, duke shtuar pasaportat e zakonshme në mënyrë që për to të zbatohen dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

Ndryshimi i paragrafit 2 dhe 3 të nenit 2 si më poshtë vijon:

Shtohen fjalët “brenda periudhës 180 ditore”, në fund të çdo paragrafi.

Kjo notë diplomatike dhe nota diplomatike nr. MOFAIC/ILW/2022/47664, datë 10 nëntor 2022 do të bëhen një Marrëveshje amenduese e marrëveshjes së sipërpërmendur të nënshkruar më 13 prill 2015 në përputhje me përcaktimet e paragrafit 1, të nenit 11, dhe do të konsiderohen si një aneks i saj.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Republikës së Shqipërisë ka nderin të informojë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Emirateve të Bashkuara Arabe se autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë po ndjekin procedurat e kërkuara për prezantimin e ndryshimeve të dakorduara në përputhje me shkëmbimin e Notave Diplomatieke, dhe procedurat ligjore në përputhje me përcaktimet e nenit 12 të Marrëveshjes.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Republikës së Shqipërisë ka nderin të konfirmojë se propozimi i sipërpërmendur është i pranueshëm për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe se Nota juaj dhe kjo përgjigje së bashku, do të përbëjnë një marrëveshje midis dy qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në përputhje me nenin 12 të marrëveshjes.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Republikës së Shqipërisë përfiton nga rasti për t'i përsëritur Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Emirateve të Bashkuara Arabe, sigurimet e konsideratës së saj më të lartë.

Tiranë, 9 shkurt 2023

Për: Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit

Ndërkombëtar të Emirateve të Bashkuara Arabe

VENDIM

Nr. 153, datë 13.3.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 45, DATË 29.1.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KALIMIN NË ADMINISTRIM TË
MINISTRISË SË BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE TË
FONDIT TË TOKËS BUJQËSORE TË
ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE
DHE ISH-INSTITUCIONEVE
KËRKIMORE-SHKENCORE TË KËSAJ
MINISTRIE, AKTUALISHT NË
DISPOZICION TË AGJENCISË SË
KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË
PRONAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 45, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në të gjithë përmbajtjen e vendimit, emërtesa “Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohet me “Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1 Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, me sipërfaqe 637 068.3 (gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e tetë pikë tre) m², të përbërë nga pasuritë me nr. 291, nr. 292, nr. 293/1, nr. 294/1, zona kadastrale 2281, me vendndodhje në Fermë-Cërrik, Bashkia Cërrik, qarku Elbasan, dhe pasuritë me nr. 3/7, nr. 3/9, nr. 4/1, nr. 4/2, nr. 5/2, zona kadastrale 2264, me vendndodhje në Krane, Bashkia Finiq, qarku Vlorë, të përcaktuara në shtojcën 2 dhe në planet e rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.”.



2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 2

Nr.	Nr. pasurie	Zona kadastrale	Indeksi	Sipërfaqja (m ²)	Fshati	Bashkia	Qarku
1	3\7	2264	J-34-5-(83-A)	10000	Krane	Fëriq	Vlorë
2	3\9	2264	J-34-5-(83-A)	10000	Krane	Fëriq	Vlorë
3	4\1	2264	J-34-5-(83-A)	20000	Krane	Fëriq	Vlorë
4	4\2	2264	J-34-5-(83-A)	15000	Krane	Fëriq	Vlorë
5	5\2	2264	J-34-5-(83-A)	10000	Krane	Fëriq	Vlorë
6	291	2281	K-34-100-(224-D)-(240-B)	165480	Fermë-Cërrik	Cërrik	Elbasan
7	292	2281	K-34-100-(224-D)-(240-B)-(209-C)	164240	Fermë-Cërrik	Cërrik	Elbasan
8	293/1	2281	K-34-100-(240-B)-(225-A)-(209-C)	162148.3	Fermë-Cërrik	Cërrik	Elbasan
9	294/1	2281	K-34-100-(240-B)-(225-A)	80200	Fermë-Cërrik	Cërrik	Elbasan
TOTALI				637068.3			

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. DATË 09/02/2023 QËLIMI Pozicionim Pasiurie

VENDNDODHJA: BASHKIA Cërrik DREJTORIA E ASHK: ELBASAN ZONA KADASTRALE: 2281 (CERRIK-FERM) INDEKS HARTË: K-34-100 (240 B) (225 A) (209 C)

TE DHENAT E PASURISE: LLOJIT PASURISE ARE SIP E PASURISE 162148.3 m² SIP. E GIURMES SE NDERTIMIT --- m² NR. I KATEVE --- NR. I PEMEVE ---

X = 499191.249 Y = 4544484.883

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X = 600483.104 Y = 4544484.883

SHK. 1: 2500

X = 600483.104 Y = 4544484.883

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID / NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT
1.	VERI					
2.	LINDJE					
3.	JUGE					
4.	PERENDIM					

REALIZOI PËR SUBJEKT PRIVAT
EMRI: DHIMITER RRUMBULLAKU
LICENSA nr. T.05233/1 DATE 27/04/2017
KOMPANIA: ---
NIPTI: L07512601G

REALIZOI PËR ASHK:
SPECIALISTI: ---
DV / ASHK: ---
NËNSHKRUIMI: ---
KONFIRMIMI: ---
PËRGJEGJËSI / DREJTORI: ---
NËNSHKRUIMI / VULA: ---

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Z+O+T
Kode për teknologjinë e matjeve: T - terren , Z - zyrë , O - ortofoto , G - GPS , S - stacion Total D - Matje Distancash
PËRCAKTIMI I KUFIRIT: HK
Kode për përcaktimin e kufirit: P - përfaqësues i pronarëve , K - Kufitarët të gjithë , K P - Kufitarët pjesërisht , PB - Përfaqësues Bashkie, HK - Harta Kadastrale
SHËNIME TË VEÇANTA:
SAKTESOHET SIPERFAQJA E PASURISE: 293/1 E LLOJIT ARE ME SIPERFAQE 162,148.3 m² SIPAS TERRENIT, E REGJISTRUAR NE KARTELEN E PASURISE ME SIP. 162,148.3 m².

PRONARI / BASHKËPRONARËT- DEKLARIM NDARJEN E PASURISE: ---
EMRI: MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL.
NËNSHKRUIMI: ---



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. DATË 09/02/2023 QËLLIMI Pozicionim Pasurie

VENDNDODHJA
BASHKIA Cerrik DREJTORIA E ASHK ELBASAN ZONA KADASTRALE 2281(CERRIK-FERM) INDEKS HARTE: K-34.100 (224 D) (240 D) (209 C)
TË DHËNAT E PASURISË
LLOJTI PASURISË ARË SIP E PASURISË 164220 m² SIP. E GJURMËS SË NDËRTIMIT --- m² NR. I KATEVE --- NR. I PEMËVE ---

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SHK. 1: 2500

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID / NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT
1.	VERI					
2.	LINDJE					
3.	JUGE					
4.	PERENDM					

REALIZOI PËR SUBJEKT PRIVAT

EMRI: DHIMITER RRUMBULLAKULËJENSA nr. T.0523/1 DATE 27 / 04 / 2017

KOMPANIA:

NIPT: L07512601G

REALIZOI PËR ASHK:

SPECIALISTI:

DV / ASHK:

NËNASHKRUIMI:

KONFIRMIMI:

PËRGJEGJËSI / DREJTORI:

NËNASHKRUIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Z+O+T

Kode për teknologjinë e matjeve: T - terren, Z - zyrë, O - ortofoto, G - GPS, S - stacion Total D - Matje Distancash

PËRCAKTIMI I KUFIRIT: HK

Kode për përcaktimin e kufirit: P - përfaqësues i pronarëve, K - Kufitarët të gjithë, K P - Kufitarët pjesërisht, PB - Përfaqësues Bashkie, HK - Harta Kadastrale

SHËNIME TË VEÇANTA:

SAKTESOHET SIPERFAQJA E PASURISË: 292 E LLOJIT ARË ME SIPERFAQE 164,220 m² SIPAS TERRENIT, E REGJISTRUAR NE KARTELEN E PASURISË ME SIP. 164,220 m².

PRONARI / BASHKËPRONARËT - DEKLARIM NDARJEN E PASURISË:

EMRI: MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL.

NËNASHKRUIMI



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. DATË 09/02/2023 QËLLIMI Pozicionim Pasurie

VENDNDODHJA BASHKIA CERRIK DREJTORIA E ASHK ELBASAN ZONA KADASTRALE 2281(CERRIK-FERM) INDEKS HARTE: K-34-100 (224 D) (240 B)
 TË DHËNAT E PASURISË LLOJIT PASURISË ARË SIP E PASURISË 165480 m² SIP. E GJURMËS SË NDËRTIMIT --- m² NR. I KATEVE --- NR. I PEMËVE ---

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SHK. 1: 2500

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPIT KUFIRIT	KUFITARI	ID / NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT
1.	VERI					
2.	LINDJE					
3.	JUGE					
4.	PERENDIM					

REALIZOI PËR SUBJEKT PRIVAT

EMRI: DHIMITER RRUMBULLAKU
 LICENSA nr. T.0523/1 DATË 27/04/2017
 KOMPANIA: Geoservis
 NIPTI: L07512601G

REALIZOI PËR ASHK:

SPECIALISTI: _____

DV / ASHK: _____

NËNSHKRUIMI: _____

KONFIRMOI: _____

PËRGJEGJËSI / DREJTORI: _____

NËNSHKRUIMI / VULA: _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Z+O+T

Kode për teknologjinë e matjeve: T - terren , Z - zyrë , O - ortofoto , G - GPS , S - stacion Total D - Matje Distancash

PËRCAKTIMI I KUFIRIT: HK

Kode për përcaktimin e kufirit: P - përfaqësues i pronarëve , K - Kufitarët të gjithë , KP - Kufitarët pjesërisht , PB - Përfaqësues Bashkie , HK - Harta Kadastrale

SHËNIME TË VEÇANTA:

SAKTESOHET SIPERFAQJA E PASURISË: 291 E LLOJIT ARË ME SIPERFAQE 165,480 m² SIPAS TERRENIT, E REGJISTRUAR NE KARTELEN E PASURISE ME SIP. 165,480 m².

PRONARI / BASHKËPRONARËT- DEKLARIM NDARJEN E PASURISË: _____

EMRI: MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL.

NËNSHKRUIMI: _____



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. DATË 09/02/2023 QËLLIMI Pozicionim Pasurie

VENDNDODHJA
BASHKIA Cerrik DREJTORIA E ASHK ELBASAN ZONA KADASTRALE 2281(CERRIK-FERM) INDEKS HARTE: K-34-100-(240-B)-(225-A)

TE DHENAT E PASURISE
LLOJIT PASURISE ARË SIP E PASURISE 80200 m² SIP. E GJURMËS SË NDËRTIMIT --- m² NR. I KATEVE --- NR. I PEMËVE ---

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X = 499191.240
Y = 4544484.853

X = 500463.184
Y = 4544484.853

SHK. 1: 2500

X = 500463.184
Y = 4544484.853

SHPJEGUES:
PËR SAKTESIM PASURIE:
Saktesohet Pasuria 294/1
me sip. të regjistruar 84.237.5 m² sipas
terrenit dhe behet:
Pasuria nr. 294/1 (Arë) = 80.200 m²

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID / NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT
1.	VERI					
2.	LINDJE					
3.	JUGE					
4.	PERENDIM					

REALIZOI PËR SUBJEKT PRIVAT
EMRI: DHEMETER RRUMBULLAKU
LËGENSA nr. T.0523/1 DATË 27 / 04 / 2017
KOMPANGA: _____
NIPTI: L07512601G

REALIZOI PËR ASHK:
SPECIALISTI: _____
DV / ASHK: _____
NËNSHKRIMI: _____
KONFIRMOC: _____
PËRGJEGJËSI / DREJTORI: _____
NËNSHKRIMI / VULA: _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Z+O+T
Kode për teknologjinë e matjeve: T - terren , Z - zyrë , O - ortofoto , G - GPS , S - stacion Total D- Matje Distancash
PËRCAKTIMI I KUFIRIT: HK
Kode për përcaktimin e kufirit: P - përfaqësues i pronarëve , K - Kufitarët të gjithë , KP - Kufitarët pjesërisht , PB - Përfaqësues Bashkie , HK - Harta Kadastrale
SHËNIME TË VEÇANTA:
SAKTESOHET SIPERFAQJA E PASURISE: 294/1 E LLOJIT ARË ME SIPERFAQE 80,200 m² SIPAS TERRENIT, E REGJISTRUAR NE KARTELEN E PASURISE ME SIP. 84,237.5 m².

PRONARI / BASHKËPRONARËT- DEKLARIM NDARJEN E PASURISE: _____
EMRI: MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL.
NËNSHKRIMI: _____



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI: Shtet		DATE 12.12.2022		QELLIMI: Regjistrim		
VENDNDODHJA						
BASHKIA SARANDE		DV ASHK SARANDE		ZONA KADASTRALE 2264(KRANE)		NUMRI PASURISE 3/7
INDEKS HARTE:J-34-5-(83-A)						
TE DHENAT E PASURISE						
LLOJI PASURISE "ARE"		SIP.PASURISE=10.000,0m ²		SIPERFAQE GJURMES SE NDERTIMIT=_____m ²		NUMRI KATEVE_____
NUMRI I PEMEVE_____						
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE						
Y=420431.5030 X=418231.2526					Y=421103.7677 X=418231.2526	
SH 1:2500						
Y=420431.5030 X=417774.8420					Y=421103.7677 X=417774.8420	
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	Veriu	_____	_____	Pas.nr.3/6,3/9	_____	_____
2	Lindje	_____	_____	Pas.nr.23/1,3/9	_____	_____
3	Jug	_____	_____	Pas.nr.3/3,23/1	_____	_____
4	Perendim	_____	_____	Pas.nr.3/3	_____	_____
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI MBIEMRI:Barjam Alidhima LICENCA NR.T.0473/2 DATE 31.01.2017 KOMPANIA _____ NIPT :L64805801P Barjam Alidhima NENSHKRIMI/VULA _____ REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI _____ DV ASHK _____ NENSHKRIMI _____ KONFIRMOI PERGJEGJESI/DREJTORI _____ NENSHKRIMI/VULA _____ TEKNOLOGJIA E MATJEVE .T,Z,O,S. Kode për teknologjinë e matjeve: T-Teren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash PERCAKTIMI I KUFIRIT :P,H,K. Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarëve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie; HK-Harta Kadastrale SHENIME TE VECANTA: Koordinatat janë në sistemin Gauss-Kryger, zona 4. Harta baze është Harta e Regjistrimit të ASHK,DV Sarande. _____ _____ PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI _____ MBIEMRI _____						

SHPJEGUES

KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE
SIPERFAQE=10000m²

KUFIRI SIPAS GJENDJES FAKTIKE
SIPERFAQE=10000m²



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI:Shtet

DATE 12.12.2022

QELIMI:Regjistrim

VENDNDODHJA

BASHKIA SARANDE

DV ASHK SARANDE

ZONA KADASTRALE 2264(KRANE)

NUMRI PASURISE 3/9

INDEKS HARTE:J-34-5-(83-A)

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE "ARE"

SIP.PASURISE=10.000,0m²SIPERFAQE GJURMES SE NDERTIMIT=_____m²


NUMRI KATEVE_____

NUMRI I PEMEVE_____

Y=420470.9279 X=418255.5066

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

Y=421128.5871 X=418255.5066



Y=420470.9279 X=417814.3813

SH 1:2500

Y=421128.5871 X=417814.3813

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	Veriu			Pas.nr.3/8,23/6		
2	Lindje			Pas.nr.23/6		
3	Jug			Pas.nr.3/7		
4	Perendim			Pas.nr.3/7,3/6		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI MBIEMRI:Barjam Alidhima

LICENCA NR. T.0473/2 DATE 31.01.2017

KOMANIA

NIPT :L64805801P Barjam

NENSHKRIMI/VULA:Alidhima

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI

DV ASHK

NENSHKRIMI

KONFIRMOI

PERGJEGJES/DREJTORI

NENSHKRIMI/VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE :T,Z,O,S.

Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash

PERCAKTIMI I KUFIRIT :P,H,K.

Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarëve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht;

PB-Përfaqësues Bashkie; HK-Harta Kadastrale

SHENIME TE VECANTA:

Koordinatat janë në sistemin Gauss-Kryger, zona 4.

Harta baze është Harta e Regjistrimit të ASHK, DV Sarandë.

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI _____ MBIEMRI _____



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE							
PRONARI: Shtet		DATE 12.12.2022		QELLIMI: Regjistrim			
VENDNDODHJA							
BASHKIA SARANDE		DV ASHK SARANDE		ZONA KADASTRALE 2264(KRANE)		NUMRI PASURISE 4/1 INDEKS HARTE:J-34-5-(83-A)	
TE DHENAT E PASURISE							
LLOJI PASURISE "ARE"		SIP.PASURISE=20.000,0m ²		SIPERFAQE GJURMES SE NDERTIMIT=_____m ²		NUMRI KATEVE_____ NUMRI I PEMEVE_____	
Y=420470.9279 X=418255.5066		KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE				Y=421128.5871 X=418255.5066	
Y=420470.9279 X=417814.3813		SH 1:2500				Y=421128.5871 X=417814.3813	
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	
1	Veriu	_____	_____	Pas.nr.4/2,23/1	_____	_____	
2	Lindje	_____	_____	Pas.nr.4/2	_____	_____	
3	Jug	_____	_____	Pas.nr.23/1	_____	_____	
4	Perendim	_____	_____	Pas.nr.23/1	_____	_____	
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI MBIEMRI:Barjam Alidhima LICENCA NR .T.0473/2 DATE 31.01.2017 KOMPANIA _____ NIPT :L64805801P Barjam Alidhima NENSHKRIMI/VULA _____ REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI _____ DV ASHK _____ NENSHKRIMI _____ KONFIRMOI PERGJEGJESI/DREJTORI _____ NENSHKRIMI/VULA _____ TEKNOLOGJIA E MATJEVE .T.Z.O.S. Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash PERCAKTIMI I KUFIRIT :P,HK. Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarëve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie; HK-Harta Kadastrale SHENIME TE VECANTA: Koordinatat janë në sistemin Gauss-Kryger zona 4. Harta baze është Harta e Regjistrimit të ASHK,DV Sarande. _____ _____ PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI _____ MBIEMRI _____							



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE							
PRONARI: Shtet		DATE 12.12.2022		QELLIMI: Regjistrim			
VENDNDODHJA							
BASHKIA_SARANDE		DV ASHK SARANDE		ZONA KADASTRALE 2264(KRANE)		NUMRI PASURISE 4/2 INDEKS HARTE:J-34-5-(83-A)	
TE DHENAT E PASURISE							
LLOJI PASURISE "ARE"		SIP.PASURISE=15.000,0m ²		SIPERFAQE GJURMES SE NDERTIMIT=_____m ²		NUMRI KATEVE_____ NUMRI I PEMEVE_____	
Y=420463.2778 X=418416.0615		KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE				Y=421146.6627 X=418416.0615	
Y=420463.2778 X=417950.1408		SH 1:2500				Y=421146.6627 X=417950.1408	
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	
1	Ventu	_____	_____	Pas.nr.4/3,23/1	_____	_____	
2	Lindje	_____	_____	Pas.nr.4/3	_____	_____	
3	Jug	_____	_____	Pas.nr.23/1	_____	_____	
4	Perendim	_____	_____	Pas.nr.4/1	_____	_____	
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT							
EMRI MBIEMRI:Barjam Alidhima							
LICENCA NR.:T.0473/2 DATE 31.01.2017							
KOMPANIA							
NIPT :L64805801P Barjam Alidhima							
NENSHKRIMI/VULA Atidhima							
REALIZOI PER ASHK							
SPECIALISTI _____							
DV ASHK _____							
NENSHKRIMI _____							
KONFIRMOI							
PERGJEGJESI/DREJTORI _____							
NENSHKRIMI/VULA _____							
TEKNOLOGJIA E MATJEVE .T,Z,O,S.							
Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash							
PERCAKTIMI I KUFIRIT :P,H,K.							
Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarëve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie; HK-Harta Kadastrale							
SHENIME TE VECANTA:							
Koordinatat janë në sistemin Gauss-Kryger zona 4.							
Harta baze është Harta e Regjistrimit të ASHK,DV Sarande.							
PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET							
EMRI _____ MBIEMRI _____							



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																									
PRONARI: Shtet		DATE 12.12.2022		QELIMI: Regjistrim																																					
VENDNDODHJA																																									
BASHKIA SARANDE		DV ASHK SARANDE		ZONA KADASTRALE 2264(KRANE)		NUMRI PASURISE 5/2																																			
INDEKS HARTE:J-34-5-(83-A)(67-C)																																									
TE DHENAT E PASURISE																																									
LLOJI PASURISE "ARE"		SIP.PASURISE=10.000,0m ²		SIPERFAQE GJURMES SE NDERTIMIT=_____m ²		NUMRI KATEVE_____																																			
NUMRI I PEMEVE_____																																									
Y=420712.0058 X=418633.4152 KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE Y=421396.2036 X=418633.4152																																									
SH 1:2500																																									
Y=420712.0058 X=418165.4861																																									
Y=421396.2036 X=418165.4861																																									
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 5%;">Nr.</th> <th style="width: 20%;">ORIENTIMI</th> <th style="width: 15%;">PERDORIMI</th> <th style="width: 15%;">TIPI KUFIRIT</th> <th style="width: 20%;">KUFITARI</th> <th style="width: 10%;">ID/NIPT</th> <th style="width: 25%;">SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Veriu</td> <td></td> <td></td> <td>Pas.nr.23/2</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Lindje</td> <td></td> <td></td> <td>Pas.nr.23/2</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Jug</td> <td></td> <td></td> <td>Pas.nr.5/1,23/1</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Perendim</td> <td></td> <td></td> <td>Pas.nr.23/1,5/1</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>							Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	Veriu			Pas.nr.23/2			2	Lindje			Pas.nr.23/2			3	Jug			Pas.nr.5/1,23/1			4	Perendim			Pas.nr.23/1,5/1		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																			
1	Veriu			Pas.nr.23/2																																					
2	Lindje			Pas.nr.23/2																																					
3	Jug			Pas.nr.5/1,23/1																																					
4	Perendim			Pas.nr.23/1,5/1																																					
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 50%; vertical-align: top; padding: 5px;"> REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI MBIEMRI: Barjam Alidhima LICENCA NR. T.0473/2 DATE 31.01.2017 KOMPANIA _____ NIPT :L64805801P Barjam Alidhima NENSHKRIMI/VULA _____ REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI _____ DV ASHK _____ NENSHKRIMI _____ KONFIRMOI PERGJEGJESI/DREJTORI _____ NENSHKRIMI/VULA _____ </td> <td style="width: 50%; vertical-align: top; padding: 5px;"> TEKNOLOGJIA E MATJEVE T,Z,O,S. Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash PERCAKTIMI I KUFIRIT :P,H,K. Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarëve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie; HK-Harta Kadastrale SHENIME TE VECANTA: Koordinatat jane ne sistemin Gauss-Kryger.zona 4. Harta baze eshte Harta e Regjistrimit te ASHK,DV Sarande. PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI _____ MBIEMRI _____ </td> </tr> </table>							REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI MBIEMRI: Barjam Alidhima LICENCA NR. T.0473/2 DATE 31.01.2017 KOMPANIA _____ NIPT :L64805801P Barjam Alidhima NENSHKRIMI/VULA _____ REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI _____ DV ASHK _____ NENSHKRIMI _____ KONFIRMOI PERGJEGJESI/DREJTORI _____ NENSHKRIMI/VULA _____	TEKNOLOGJIA E MATJEVE T,Z,O,S. Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash PERCAKTIMI I KUFIRIT :P,H,K. Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarëve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie; HK-Harta Kadastrale SHENIME TE VECANTA: Koordinatat jane ne sistemin Gauss-Kryger.zona 4. Harta baze eshte Harta e Regjistrimit te ASHK,DV Sarande. PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI _____ MBIEMRI _____																																	
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI MBIEMRI: Barjam Alidhima LICENCA NR. T.0473/2 DATE 31.01.2017 KOMPANIA _____ NIPT :L64805801P Barjam Alidhima NENSHKRIMI/VULA _____ REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI _____ DV ASHK _____ NENSHKRIMI _____ KONFIRMOI PERGJEGJESI/DREJTORI _____ NENSHKRIMI/VULA _____	TEKNOLOGJIA E MATJEVE T,Z,O,S. Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash PERCAKTIMI I KUFIRIT :P,H,K. Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarëve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie; HK-Harta Kadastrale SHENIME TE VECANTA: Koordinatat jane ne sistemin Gauss-Kryger.zona 4. Harta baze eshte Harta e Regjistrimit te ASHK,DV Sarande. PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI _____ MBIEMRI _____																																								

SHPJEGUES

KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE
SIPERFAQE=10000m²

KUFIRI SIPAS GJENDJES FAKTIKE
SIPERFAQE=10000m²



VENDIM
Nr. 154, datë 13.3.2023

**PËR SHPALLJEN E HABITATIT TË
TULIPANIT SHQIPTAR “MONUMENT
NATYROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e habitatit të tulipanit shqiptar (*Tulipa albanica*) “Monument natyror”, kategoria III e zonave të mbrojtura, sipas hartës në shtojcën 1, dhe kufirit të paraqitur sipas tabelës së koordinatave në shtojcën 2, që i bashkëlidhen këtij

vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Monumenti i natyrës ka një sipërfaqe 35.5 ha dhe zonë buferike 200 m rreth kufirit të zonës të mbrojtur, në të cilin zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes e njëjtë me rezervën strikte.


3. Zona e mbrojtur përfshin habitatin e një lloji të rrallë e të kërcënuar me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike, sipas aneksit nr. 1, i cili përmban skedën e monumentit të natyrës.

4. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe organet përkatëse të vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Shtojca nr. 1





Shtojca nr. 2

Lista me koordinatat (ETRS 89 ALBNAIA 2010 e vendndodhjes së habitatit të Tulipanit shqiptar (*Tulipa albanica*), Surroj.

KOORDINATA E PIKAVE		
SISTEMI ETRS 89 ALBANIA 2010		
Nr	X	Y
1	527189	4656500
2	527316	4656484
3	527340	4656486
4	527442	4656451
5	527481	4656446
6	527542	4656449
7	527619	4656439
8	527683	4656437
9	527700	4656443
10	527741	4656447
11	527778	4656459
12	527878	4656464
13	527931	4656484
14	527980	4656455
15	527960	4656562
16	527966	4656632
17	527961	4656767
18	527927	4656832
19	527873	4656831
20	527843	4656861
21	527802	4656861
22	527706	4656892
23	527593	4656914
24	527503	4656926
25	527459	4656940
26	527404	4656948
27	527337	4656950
28	527320	4656951
29	527250	4656933
30	527202	4656942
31	527134	4656925
32	527153	4656756
33	527163	4656717
Sip=35.5 ha		



Aneksi nr. 1

HABITATI I TULIPANIT SHQIPTAR (*Tulipa albanica*)

Monument Natyror (III)

1. Taksonomia Mbretëria: Plantea Ndarja: Tracheophyta Klasa: Liliopsida Rendi: Liliales Familja: Liliaceae Gjinia: Tulipa	2. Rajoni biogeografik ALPINE	3. Vendndodhja lokale Bashkia:Kukës Njs.Adm.:Surroj Fashti:Fushare	4. Koordinatat e qendrës (KRRG.JSH 2010) X 527507 Y 4656729 Lartësia mnd 550-750m *Koordinanat e plota bashkëlidhur shtojcës	5. Sipërfaqja (ha) Sipërfaqja 35.5 ha Zona buferike: 200 m rreth kufirit të zonës qendrore.
6. Habitat Pyje të temperuar 41.26 <i>Galio-Carpinetum</i> oak-hornbeam forests (Habitat Directive) 6.1 Përshkrimi i habitatit Kryesisht në celtira mes pyjeve të <i>Quercus</i> spp, <i>Forsythia europae</i> , <i>Juniperus oxycedrus</i> të dominuara nga <i>Polygalo-Forsythietum europaeae</i> dhe shoqërimet e aleancës <i>Quercus-Carpinion orientalis</i> . Takohet në terren të pjerrët, shkëmbinj gëlqeror, në substratin serpentinor, në lartësi 550-750m mbi rrafshin e detit. Tokat janë të kafejta acide. Kundrejtimi i sipërfaqes është nga lindja. Cilësia e habitatit po bie me humbjen e lëndëve ushqyese për shkak të mbulesës së ulët të bimësisë dhe përbërjes së substratit.		7. Bashkëshoqërimet bimore <i>Polygalo-Forsythietum europaeae</i> Shoqërimet e aleancës <i>Quercus-Carpinion orientalis</i> . Tulipani në habitatin e tij shoqërohet me llojet: <i>Aristolochia merxmulleri</i> , <i>Halacsya sendneri</i> , <i>Paramoltkia doerfleri</i> , <i>Polygala doerfleri</i> , <i>Sanguisorba albanica</i> , <i>Veronica andrasovszkyi</i> , <i>Aster albanicus</i> subsp. <i>albanicus</i> dhe specie relikte terciare të <i>Euphorbia glabriflora</i> , <i>Genista hassertiana</i> dhe <i>Dioscorea balcanica</i> .		8. Përdorimi i territorit (mbulesa) -Pyll, forma e qeverisjes Shkurre dominuar nga Bushi (<i>Buxus sempervirens</i>) si dhe . Dëllinjë e kuqe dhe e zezë, Frashër, Shkozë, Trëndafil të egër, shoqëruar me bimësi barishtore (Graminace, Bishtajore, etj).
9. Përcaktimi i kërcënimeve Minierat, Zjarri, Kullotja e bagëtive, Grumbullimi i bimëve mjekësore, i barrit dhe i vet tulipanit për tregti dhe zbukurim, hedhja e inerteve, mbetjeve urbane.		10. Statusi i kërcënimit të llojit Në rrezik kritik (CR); popullatat në rënie.	11. Statusi i ruajtjes kombëtar/ndërkombëtar (i pa listuar)	12. Objektivi kryesor i menaxhimit Ruajtja/e habitateve të Tulipa albanica, si lloj endemic, në rrezik kritik,si dhe frenimi i përdorimit të tokës për qëllime të tjera.
13. Masat kryesore për konservim Shpallja zonë e mbrojtur e habitatit me qëllim ndalimin e përdorimit të sipërfaqes për miniera, ndalimin e kullotjes së çfarëdolloj të bagëtive, ndalimin e hedhjes së inerteve dhe të mbetjeve urbane. Dhënia e statusit të mbrojtjes në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Hartimi i planit të veprimit për mbrojtjen e llojit. Ndalimin e marrjes së individëve për qëllime tregtimi apo mbjelljes në kopshte për zbukurim. Monitorimin e rregullt të gjendjes së habitatit në periudhën e lulëzimit. Rritja e prezencës së kontrollit në periudhën e lulëzimit kryesisht kur lloji bëhet i dukshëm në sipërfaqe. Marria e masave kundër zjarrit.				14.Administrata përgjegjëse AdZM, qarku Kukës



VENDIM
Nr. 3, datë 7.2.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Marsida Xhaferllari	kryesuese,
Elsa Toska	anëtare,
Sonila Bejtja	anëtare,
Sandër Beci	anëtar,
Ilir Toska	anëtar,
Genti Ibrahim	anëtar,
Marjana Semini	anëtare,
Holta Zaçaj	anëtare,
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 7.2.2023
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 2 (N) 2022 të Regjistrit
Themeltar, që u përket:

KËRKUES: NESHAT MAZE

SUBJEKT I INTERESUAR:

MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-
771 (142), datë 31.3.2022, të Kolegjit Administrativ
të Gjykatës së Lartë, si i pajtueshëm me
Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1,
shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të
Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i
Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
(*KEDN*); nenet 27, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577,
datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin
e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së
Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji,
mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të
kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës,
parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar,
Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, të
përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit, që ka kërkuar
rrefuzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në
tërësi,

VERËN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Neshat Maze, me kontratën nr.
18390 rep., nr. 4786 kol., datë 11.8.1992, ka blerë
kundrejt shpërblimit nga ish-Komiteti Ekzekutiv
PP Rajoni 2, Tiranë një truall me sipërfaqe 280 m²,
ndërsa më herët në favor të kërkuesit ishte miratuar
një leje për ndërtim. Akti i fitimit të pronësisë është
regjistruar rregullisht në zyrën e hipotekës, Tiranë.

2. Trualli i blerë nga kërkuesi është bërë objekt
zbatimi i ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për
kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve”,
të ndryshuar (*ligji nr. 7698/1993*). Me vendimin nr.
316, datë 16.9.2000, Komisioni i Kthimit dhe
Kompensimit të Pronave, Tiranë (*KKKP*) ka njohur
të drejtën e pronësisë në favor të ish-pronarit A.P.
për truallin me sipërfaqe 280 m², duke ua kthyer atë
trashëgimtarëve të tij. Në këtë vendim *KKKP*-ja
nuk ka trajtuar situatën që krijohet për kërkuesin
lidhur me të drejtën e shpërblimit, sikurse dhe ligji i
veçantë përcaktonte. Në këto kushte, pasi ka rënë
në dijeni të vendimit të *KKKP*-së, në vitin 2013
kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit
Gjyqësor Tiranë me një kërkesëpadi, duke kërkuar
anulimin pjesërisht të vendimit të *KKKP*-së për sa
nuk ishte shprehur për të drejtën e tij të
shpërblimit, si dhe detyrimin e Ministrisë së
Financave për shpërblimin e drejtë të pronës truall
me sipërfaqe 280 m² (*procesi i parë gjyqësor*).

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me
vendimin nr. 5522, datë 5.5.2014, ka pranuar
pjesërisht padinë. Ajo ka detyruar të paditurin,
Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, t’i paguajë
paditësit Neshat Maze dëmshpërblimin e pronës në
shumën 6.573.035 (gjashtë milionë e pesëqind e
shtatëdhjetë e tre mijë e pesëdhjetë e tre) lekë, si
pasojë e vendimit nr. 316, datë 16.9.2000 të
KKKP-së. Nga ana tjetër, gjykata ka rrëzuar padinë
për pjesën tjetër, për anulimin pjesërisht të
vendimit nr. 316, datë 16.9.2000 të *KKKP*-së. Ky
vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit
Tiranë me vendimin nr. 387, datë 13.2.2015 dhe
Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.
00-2016-659, datë 15.3.2016, ka vendosur
mospranimin e rekursit të paraqitur nga Ministria e
Financave dhe Ekonomisë.



4. Në vijim, më datë 31.3.2016, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar një kërkesëpadi tjetër e kërkuarit, me të cilën ka kërkuar detyrimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë t'i paguajë dëmin e shkaktuar si rrjedhim i vonesës në pagimin e shpërblimit të njohur me vendim gjyqësor përfundimtar. Ky dëm është kërkuar të llogaritet në formën e kamatëvonesave për vlerën e shpërblimit të njohur (6.573.035 lekë), ku si ditë e fillimit të vonesës është pretenduar data 16.9.2000, kur KKKP-ja ka vendosur kthimin e pronës në favor të ish-pronarit pa i akorduar kërkuarit shpërblimin sipas ligjit, njohur tashmë me vendim gjyqësor, shpërblim ku detyrimi për pagimin e të cilit nga institucionet shtetërore ka lindur në këtë datë. Kurse si ditë e mbarimit të vonesës është pretenduar data 11.6.2016, kur kërkuari ka përfituar shpërblimin e njohur me vendim gjyqësor (*procesi i dytë gjyqësor*).

5. Në procesin e dytë gjyqësor Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 429, datë 27.1.2017, ka vendosur: *“Pranimin e padisë. Detyrimin e palës së paditur Ministria e Financave, të paguajë në favor të paditësit Neshat Maze shumën prej 8.916.513 lekësh, shumë kjo e cila përfaqëson vlerën e dëmit të shkaktuar për periudhën nga data 16.9.2000, deri më datë 11.10.2016, si rrjedhim i vonesës në pagimin e shpërblimit të njohur me vendimin nr. 5522, datë 5.5.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”*. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim subjekti i interesuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1748, datë 11.7.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 429, datë 27.1.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur rekurs, si dhe ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, fillimisht, me vendimin nr. 550, datë 22.11.2017, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës së paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 429, datë 27.1.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1748, datë 11.7.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë.”*. Ndërsa me vendimin nr. 550/1, datë 8.4.2019 ka vendosur: *“Mospranimin e kërkesës së Neshat Maze për revokimin e vendimit nr. 550, datë 22.11.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.”*.

8. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar rekursin në dhomën e këshillimit dhe me vendimin nr. 00-2022-771 (142), datë 31.3.2022 ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1748, datë 11.7.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 429, datë 27.1.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke rrëzuar padinë. Sipas Gjykatës së Lartë, për sa kohë që vendimi i KKKP-së nuk ka parashikuar ndonjë detyrim për palën e paditur në favor të paditësit (kërkuarit), ajo nuk mund t'i paguajë atij kamatëvonesë sipas nenit 450 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ndaj padia është pa shkak të ligjshëm referuar pretendimeve të ngritura nga ai. Vlera e detyrimit të përcaktuar në vendimin gjyqësor (të procesit të parë gjyqësor) është ekzekutuar pas marrjes formë të prerë të tij dhe nëse do të kishte vonesa pas kësaj date, atëherë paditësi (kërkuari) mund të legjitimohej të kërkonte kamatëvonesën.

9. Më datë 27.7.2022, kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-771 (142), datë 31.3.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

10. Kolegji i Gjykatës më datë 30.9.2022 vendosi kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit më datë 28.10.2022 vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuari**, në kërkesën e tij, pretendon se është cenuar:

11.1 *Gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi çështja e tij duhet të ishte shqyrtuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë dhe jo nga Kolegji Administrativ, i cili nuk ka qenë kompetent nga pikëpamja lëndore, pasi kërkesëpadia me objekt shpërblimin e dëmit, e ngritur nga kërkuari, është shqyrtuar nga gjykatat civile pas datës 3.11.2013. Kërkimi kryesor ka qenë kundërshtimi i vendimit të KKKP-së dhe pasojat e tij, i cili hyn në kompetencën e gjykatave civile dhe jo atyre administrative, ndaj dhe kërkimi i shpërblimit të dëmit, rrjedhojë e vendimit të KKKP-së, është në kompetencë të juridiksionit gjyqësor civil.



11.2 *E drejta e aksesit dhe e drejta për t'u dëgjuar*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke mos e kaluar çështjen në seancë gjyqësore dhe duke mos i dëgjuar pretendimet e palëve, ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin material. Qëndrimi i mbajtur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin objekt kërkesë, bie në kundërshtim me jurisprudencën e mbajtur nga i njëjti kolegji në raste të tjera.

11.3 *E drejta e pronës*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka interpretuar dhe zbatuar gabim ligjin material. Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës, kur interpretimi dhe zbatimi i gabuar i ligjit material cenojnë të drejtën e pronës, kjo çështje hyn në juridiksionin kushtetues. Konkreisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka gabuar kur ka arsyetuar se vendimi i KKKP-së nuk ka parashikuar të drejta pronësore për kërkuar. Gjithashtu, ajo gjykatë ka gabuar edhe kur arsyeton se nuk rezulton që para datës së ngritjes së padisë për kundërshtimin e vendimit të KKKP-së, ndërmjet palëve të ekzistonte një marrëdhënie juridike për pagimin e shumës së pretenduar si principal.

12. ***Subjekti i interesuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë***, nëpërmjet Avokaturës së Shtetit, ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

12.1 Pretendimi i kërkuar për cenimin e gjykimit nga një *gjykatë e caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka pasur kompetencë lëndore për shqyrtimin e çështjes së kërkuar. Në interpretim të nenit 450 të KPC-së rezulton se, që të kërkohej kamatëvonesa, duhet të ekzistojë një marrëdhënie juridike konkrete për pagimin e një shume parash, për shkak të ligjit, kontratës ose një vendimi gjyqësor, midis dy apo më shumë personash, të cilët kanë përcaktuar qartësisht të drejtat dhe detyrimet e gjithsecilit, përfshirë edhe mënyrën e ekzekutimit ose vlerën konkrete të parave që duhen paguar.

12.2 Pretendimet për cenimin e *së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u dëgjuar, si dhe së drejtës së pronës* janë të pabazuara, pasi sipas parimit *iura novit curia*, Gjykata e Lartë nuk i merr të mirëqena shpjegimet e palëve në lidhje me zbatimin e ligjit për çështjen konkrete, por si njohëse e ligjit e zgjidh vetë mosmarrëveshjen, sipas formimit dhe bindjes së saj të brendshme, bazuar në kriteret që parashikon

Kushtetuta, KPC-ja dhe ligjet e veçanta. Gjykimi në dhomë këshilli është i përcaktuar në nenin 62 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Kërkuar nuk ka arritur të provojë në asnjë moment cenimin e kësaj dispozite dhe pse Gjykata e Lartë duhet ta zhvillonte gjykimin në seancë gjyqësore.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuar

13. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "P" dhe 134, pikat 1, shkronja "I" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të përcaktuara nga neni 71/a i ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Gjykata vëren se kërkuar legjitimohet *ratione personae* për pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "P" dhe 134, pika 1, shkronja "I", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatën Kushtetuese dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuar i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç



paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

16. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret, vërehet se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar nga kërkuesi mban datën 31.3.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë më datën 27.7.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuetit për cenimin e procesit të rregullt ligjor, në drejtim të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës për t’u dëgjuar dhe së drejtës së aksesit, përfshirë edhe të drejtën e pronës, të analizuar në këndvështrim të neneve 41 dhe 42 të Kushtetutës, hyjnë në juridiksionin kushtetues, prandaj, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata, në vijim, do të shqyrtojë bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

18. Kërkuesi pretendon se çështja e tij duhet të ishte shqyrtuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë dhe jo nga Kolegji Administrativ, i cili nuk ka qenë kompetent nga pikëpamja lëndore, pasi kërkesëpadia me objekt shpërblimin e dëmit, e ngritur nga kërkuesi, është shqyrtuar nga gjykatat civile pas datës 3.11.2013. Sipas tij, kontrolli i vendimmarrjes së gjykatave civile bëhet nga Kolegji Civil. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe njëri prej anëtarëve të trupit gjykues, i cili ka votuar kundër vendimmarrjes së Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në mendimin e tij të pakicës. Kërkimi kryesor ka qenë kundërshtimi i vendimit të KKKP-së dhe pasojat e tij, dhe është shqyrtuar nga gjykatat civile dhe jo nga ato administrative, ndaj dhe kërkimi i shpërblimit të dëmit të rrjedhur nga vendimi i KKKP-së është në kompetencë të juridiksionit gjyqësor civil.

19. Subjekti i interesuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, parashtrohet se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka pasur kompetencë lëndore për shqyrtimin e çështjes së kërkuetit. Sipas tij, në interpretim të nenit 450 të KPC-së, rezulton se që të kërkohet kamatëvonesa duhet të ekzistojë një marrëdhënie juridike konkrete për pagimin e një shume parash, për

shkak të ligjit, kontratës ose një vendimi gjyqësor, midis dy ose më shumë personash, të cilët kanë përcaktuar qartësisht të drejtat dhe detyrimet e gjithsecilit, përfshirë edhe mënyrën e ekzekutimit ose vlerën konkrete të parave që duhet paguar.

20. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

21. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element në sensin material, karakterizohet, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 22, datë 22.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se një nga elementet e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është edhe kompetenca lëndore e gjykatës, e cila me ligj është kriter përcaktues i gjykatës që do të vendosë për çështjen dhe i procedurës gjyqësore që do të ndjekë gjykimi konkret. Në përputhje me këtë parim, ligji ka parashikuar verifikimin e kompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjes me kërkesë të palëve ose me nismë të vetë gjykatës së cilës i paraqitet kërkesëpadia, pra nëse ajo është kompetente në lëndë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së paraqitur. Thelbësore në përcaktimin e kompetencës lëndore është identifikimi i natyrës së mosmarrëveshjes, konkretisht objekti dhe shkaku ligjor i saj. Këtij rregulli i nënshtrohen gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat duhet të zbatojnë përcaktimet ligjore materiale dhe procedurale për organizimin dhe funksionimin e tyre.



23. Për sa më lart, Gjykata në vijim do të vlerësojë nga pikëpamja kushtetuese nëse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka pasur kompetencë për të shqyrtuar çështjen e kërkuarit, pra, nisur nga objekti i kërimit, nëse shpërblimi i dëmit të detyrimit të njohur nga vendimmarrja e gjykatave civile është në kompetencë të juridiksionit gjyqësor administrativ.

24. Gjykata vëren se kompetenca lëndore e gjykatave administrative është përcaktuar në nenin 7 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit ato janë kompetente për mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike; mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik; mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme administrative; mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës së nëpunësve civilë. Ndërsa sipas nenit 13 të të njëjtit ligj, moskompetenca lëndore ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të shqyrtimit, dhe kur gjykata shpall me vendim moskompetencën e saj, urdhëron dërgimin e akteve gjykatës kompetente.

25. Ndërkohë, Gjykata konstaton se sipas vendimit unifikues nr. 3, datë 6.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjykatat administrative të të gjitha niveleve, të krijuara me ligjin nr. 49/2012, janë kompetente për çështjet administrative për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 4.11.2013 dhe deri në këtë datë shqyrtimi në gjykata nuk ka përfunduar akoma. Gjithashtu, Gjykata vëren se sipas vendimit unifikues nr. 4, datë 10.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, shqyrtimi i mosmarrëveshjeve me objekt kundërshtimin e vendimeve të KKKP-ve mund të bëhet vetëm nga gjykatat e zakonshme civile në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe të KPC-së. Për këto arsye, çështje të këtij lloji do të konsiderohen si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohen nga gjykata që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve civile.

26. Në çështjen në shqyrtim, nga dosja gjyqësore e administruar për nevoja të këtij shqyrtimi kushtetues, rezulton se procesi i parë gjyqësor ka përfunduar me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në vitin 2016. Çështja e moskompetencës lëndore të gjykatës civile është

ngritur nga subjekti i interesuar gjatë shqyrtimit të çështjes në apel, si dhe në rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë. Kërkesa është rrëzuar nga gjykata e apelit me arsyetimin se mosmarrëveshja është e natyrës civile dhe kompetente për të është gjykata civile, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

27. Edhe gjatë procesit të dytë gjyqësor (objekt i këtij shqyrtimi kushtetues) është diskutuar çështja e moskompetencës lëndore të gjykatës civile. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka arsyetuar se përderisa objekti i shqyrtimit janë kamatëvonesat ligjore, ato përbëjnë një kërkesë dytësore në raport me kërkimin e detyrimit kryesor të vendosur me vendimin nr. 5522, datë 5.5.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas saj, bazuar në nenin 55 të KPC-së, gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore, prandaj kompetenca i përket juridiksionit gjyqësor civil. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.

28. Për sa i përket procesit në Gjykatën e Lartë, Gjykata vëren se më datë 29.9.2017 çështja fillimisht është regjistruar në kategorinë e çështjeve civile, si dhe është caktuar relatori përkatës (anëtar i Kolegjit Civil të asaj gjykate në kohën e regjistrimit të rekursit). Pavarësisht kësaj, vendimi i ndërmjetëm për pezullimin e ekzekutimit të gjykatave të faktit është marrë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, edhe themeli i çështjes është shqyrtuar po nga Kolegji Administrativ i asaj gjykate, i cili ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave më ulëta dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Ky kolegji nuk ka arsyetuar shkaqet se përse kishte kompetencë lëndore për shqyrtimin e çështjes, ndonëse njëri prej anëtarëve të trupit gjykues ka votuar kundër, duke argumentuar me mendim pakice se në rastin konkret çështja duhej të ishte gjykuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë dhe jo nga Kolegji Administrativ.

29. Në kuptim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, si pjesë e pushtetit gjyqësor, organizohet me ligj në tre kolegje me kompetencë lëndore të ndryshme, sipas objektit të mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Për sa i takon kompetencës së kolegjeve, vërehet se Kolegji Civil shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm për çështje



tregtare, civile dhe familjare, si dhe çështje të tjera të caktuara në kompetencë me ligj, ndërsa Kolegji Administrativ shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave administrative.

30. Në kontekstin e rrethanave të mësipërme, në rastin konkret Gjykata konstaton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim dhe ka vlerësuar në themel rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar ndaj vendimeve të gjykatave të juridiksionit civil. Pavarësisht se moskompetenca lëndore shqyrtohet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të procesit, në vendimin e tij Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar se përse ishte kompetent për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, pavarësisht se çështja e kompetencës lëndore ka qenë objekt diskutimi gjatë gjithë procesit gjyqësor, përfshirë atë në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

31. Nisur nga sa më lart, në kushtet kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar duhet shfuqizuar, Gjykata çmon të mos ndalet në analizimin e pretendimeve të tjera të kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u dëgjuar dhe së drejtës së pronës, për sa kohë që çështja do të rishqyrtohet nga Gjykata e Lartë.

32. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj është i bazuar dhe duhet të pranohet sipas arsyetimit të lartpërmendur.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-771 (142), datë 31.3.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 7.2.2023.

Shpallur më 9.3.2023.

Kryesuese: Marsida Xhaferllari

Anëtarë: Sonila Bejtja, Elsa Toska, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Fiona Papajorgji, Holta Zaçaj, Marjana Semini

VENDIM

Nr. 4, datë 8.2.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	kryesuese;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Holta Zaçaj,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 17.11.2022 dhe 8.2.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 2 (K) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Klodiana Gjyzari

SUBJEKT I INTERESUAR:

Këshilli i Lartë Gjyqësor

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 78, datë 4.3.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; nr. 55, datë 29.7.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 00-2021-1923, datë 2.12.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimi i pikës 7, seksioni B, kreu X, të vendimit nr. 75, datë 23.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si e



papajftueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 49, pika 1, 118, pikat 1 dhe 2, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi parashtrimet e kërkujes Klodiana Gjyzari (*kërkujesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KL Gj*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Pas përfundimit të studimeve në Shkollën e Magjistraturës në profilin gjyqtar, kërkujesja ka ushtruar funksionin e gjyqtare fillimisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë e më pas në Gjykatën e Apelit Vlorë.

2. Me vendimet nr. 87, datë 26.2.2020 dhe nr. 243, datë 9.7.2020, KL Gj-ja ka vendosur hapjen e procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për dy pozicione të lira në fushën e së drejtës civile dhe penale, për të cilat kërkujesja ka kandiduar.

3. Me vendimin nr. 268, datë 7.8.2020, KL Gj-ja ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 87, datë 26.2.2020 dhe nr. 243, datë 9.7.2020 të KL Gj-së.

4. Në përfundim të verifikimit paraprak të kriterëve formale të kandidimit, me vendimin nr. 329, datë 17.9.2020, KL Gj-ja ka vlerësuar se kërkujesja plotësonte kriteret e përvojës profesionale minimale, mospasjes së masës disiplinore në fuqi dhe mosqenies në situatën e papajftueshmërisë ambientale, si dhe ka lejuar vijimin e procedurës së verifikimit të saj për kriteret

e tjera ligjore të kandidimit, konkretisht të pasurisë dhe figurës.

5. Me shkresën nr. 3870 prot., datë 11.8.2020, KL Gj-ja i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (*KPK*) trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit të kërkujeses, si subjekt rivlerësimi *ex officio*, sipas nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, me vendimin nr. 340, datë 1.2.2021, KPK-ja ka vendosur shkarkimin nga detyra të kërkujeses, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë. Ky vendim i është njoftuar KL Gj-së me shkresën nr. 1204 prot., datë 3.2.2021. Në datën 21.5.2021 kërkujesja ka ankimuar vendimin e KPK-së në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (*KPA*), nga faqja zyrtare e të cilit nuk rezulton të ketë ende një vendimarrje.

6. Pas marrjes dijeni për vendimin e KPK-së dhe shqyrtimit të dosjes së kandidimit, kërkujesja është njoftuar në rrugë elektronike nga KL Gj-ja për gjetjet në lidhje me një nga kriteret e procedurës së verifikimit, konkretisht atë të pasjes së masës disiplinore në fuqi, si dhe për të drejtën e saj për të paraqitur shpjegime, të cilat i ka dërguar elektronikisht në datën 1.3.2021.

7. Me vendimin nr. 78, datë 4.3.2021 (*vendimi nr. 78/2021*), KL Gj-ja, bazuar në pikën 7, seksioni B, kreu X, të vendimit nr. 75, datë 23.5.2019 të KL Gj-së, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (*vendimi nr. 75/2019*), ka vendosur, ndër të tjera, skualifikimin e kërkujeses dhe përjashtimin e saj nga procedurat për emërimin në dy pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë.

8. Në vijim, kërkujesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesëpadi, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 78/2021 të KL Gj-së, për të cilën ajo gjykatë, me vendimin nr. 55, datë 29.7.2021, ka vendosur rrëzimin e saj.

9. Për rekursin e paraqitur nga kërkujesja, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-1923, datë 2.12.2021, ka vendosur mospranimin.

10. Kërkujesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 2.4.2022, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetuese të



vendimeve të dhëna për skualifikimin e saj nga kandidimi në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile dhe penale, si dhe të pikës 7, seksioni B, kreu X, të vendimit nr. 75/2019 të KLGJ-së.

11. Në datën 9.6.2022 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, në datën 5.7.2022 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

12. Në shtator të vitit 2022 është emëruar një gjyqtar i ri kushtetues, i cili në datën 17.10.2022, bazuar në nenin 36 të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenin 18 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, i është drejtuar Kryetares së Gjykatës me kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes. Me vendimin nr. 19, datë 19.10.2022, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e saj.

13. Duke pasur parasysh se përbërja e trupit gjykues të Gjykatës ka ndryshuar, si rrjedhojë e emërimit të një gjyqtari të ri dhe zëvendësimit të dy gjyqtarëve kushtetues, të cilëve u kishte mbaruar mandati, me dy gjyqtarë të rinj, bazuar në nenet 32, pika 1 dhe 73, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata ka vendosur riçeljen e seancës plenare në datën 8.2.2023 dhe fillimin e shqyrtimit të çështjes nga e para.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

14. Kërkesja, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore dhe pika 7, seksioni B, kreu X, e vendimit nr. 75/2019 të KLGJ-së kanë cenuar këto të drejta kushtetuese:

Për procesin gjyqësor:

14.1 Të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

14.1.1 Parimit të gjykatës së caktuar me ligj, pasi Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë duhet ta kishin shqyrtuar çështjen me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë, duke qenë se objekt gjykimi ka qenë një akt normativ nënligjor.

14.1.2 Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi gjyqtarët A.G. dhe A.D., në përbërje të trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Apelit, dhe gjyqtari A.K., në përbërje të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë, kanë qenë në konflikt

interesi në shqyrtimin e çështjes, për shkak të marrëdhënieve që kanë pasur me palën e paditur ose interesit të tyre të drejtpërdrejtë në skualifikimin e saj. Nga ana tjetër, gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Apelit, A.N., ka konkurruar për dy pozicione në Gjykatën e Lartë, çka përbën dyshime të arsyeshme se edhe kjo gjyqtare ka qenë në konflikt interesi gjatë shqyrtimit të çështjes.

14.1.3 Standardit të arsytimit të vendimit, pasi gjykatat nuk janë shprehur për kërkimin e pavlefshmërisë së pikës 7, seksioni B, kreu X, të vendimit nr. 75/2019 të KLGJ-së. Arsyetimet e tyre se kërkesja ka iniciuar një gjykim incidental dhe se akti normativ nënligjor nuk ka qenë objekt i gjykimit, janë të gabuara dhe të pabazuara në prova. Po kështu, në vendimin nr. 71, datë 17.6.2021, për kërkesën për përjashtimin e gjyqtarës A.G., Gjykata Administrative e Apelit është shprehur për një shkak të pakërkuar prej saj. Kërkesa ka pasur të bëjë me procedimin disiplinor të asaj gjyqtareje dhe jo me procesin e vlerësimit profesional të saj. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë është i cekët, pa analizë dhe i pabazuar në prova.

14.1.4 Parimit të sigurisë juridike, pasi Gjykata e Lartë nuk ka riparuar të metën e gjykimit të Gjykatës Administrative të Apelit, duke mos zbatuar vendimin nr. 3, datë 29.3.2012, të Kolegejeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe duke mos mbajtur parasysh qëndrimin unifikues të saj në vendimin nr. 2 të vitit 2011. Gjykatat nuk kanë interpretuar nenet 5 dhe 31 të Kodit të Procedurës Civile, në përputhje me praktikën unifikuese, duke gabuar në përcaktimin e saktë të objektit të padisë.

14.1.5 Së drejtës së aksesit, pasi shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në dhomën e këshillimit, pa i dhënë mundësi për të paraqitur pretendime.

14.2 Të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, si rrjedhojë e skualifikimit të saj nga kandidimi në procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë. Kufizimi i kësaj të drejte është bërë në kundërshtim me nenin 17, pika 1, të Kushtetutës, pasi interpretimi nga gjykatat i masave disiplinore është bërë në tejkalim të parashikimeve kushtetuese dhe nuk është parashikuar në ligj. Ligji nr. 96/2016, datë 6.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 96/2016) nuk



barazon moskalimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës me masën disiplinore. Vendimi i KPK-së nuk është përfundimtar dhe ende nuk ka një vendim të formës së prerë të KPA-së. Cenimi i kësaj të drejte është rezultat edhe i pikës 7 të seksionit B të kreut X të vendimit nr. 75/2019 të KLGJ-së.

Për pikën 7, seksioni B, kreu X, të vendimit nr. 75/2019 të KLGJ-së:

15. Parashikimi i kësaj pike ka cenuar *rezervën ligjore dhe kufizimin me ligj të të drejtave*. Në miratimin e përmbajtjes së saj, KLGJ-ja, në tejkalim të kompetencave, ka përcaktuar një kriter të ri, të paparashikuar në ligj, në shkelje të neneve 118 dhe 17 të Kushtetutës. Neni 48 i ligjit nr. 96/2016 ka autorizuar KLGJ-në për nxjerrjen e akteve nënligjore vetëm për çështjet e parashikuara në pikën 14 të tij dhe jo për çështje të tjera, për të vendosur kritere të reja ose për interpretim të zgjeruar të tyre.

16. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka prapësuar me shkrim, duke kundërshtuar pretendimet e kërkuësës si vijon:

16.1 Dy pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me vendimet nr. 87, datë 26.2.2020 dhe nr. 243, datë 9.7.2020 të KLGJ-së, për të cilat kërkuësja ka kandiduar, janë plotësuar përmes dekreteve përkatëse.

16.2 Pretendimi i kërkuësës për cenimin e *parimit të gjykatës së caktuar me ligj* është i pabazuar. Ajo e ka orientuar kërkimin kryesor te paligjshmëria e vendimit nr. 78/2021 të KLGJ-së, i cili përbën një akt me natyrë individuale. Kërkuësja ka ngritur pretendime për pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 75/2019 të KLGJ-së, duke synuar gjykimin incidental të tij sipas nenit 38 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Gjykata Administrative e Apelit nuk ka pasur objekt shqyrtimi kontrollin parësor të aktit normativ, por kontrollin e aktit individual, për rrjedhojë ajo ishte e detyruar ta gjykonte çështjen me tre gjyqtarë.

16.3 Pretendimi i kërkuësës për cenimin e *parimit të gjykimin nga një gjykatë e paanshme* është i pabazuar. Kërkuësja nuk ka arritur të paraqesë prova bindëse se gjyqtarët e çështjes kanë shfaqur anshmëri në gjykimin e mosmarrëveshjes. Pretendimet e saj mbeten në nivel hipotetik dhe nuk arrijnë të krijojnë dyshime të arsyeshme në këtë drejtim. Vlerësimi i vendosjes së masave disiplinore

ndaj gjyqtarëve është detyrë funksionale e KLGJ-së. Fakti se një ndër anëtarët e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen është në proces procedimi disiplinor, vlerësimi ose ngritjeje në detyrë, nuk përbën premisë të mjaftueshme për të konkluduar për njëanshmëri, në rastet kur gjykohen mosmarrëveshje me palë KLGJ-në.

16.4 Pretendimi i kërkuësës se *kufizimi i të drejtave të saj është bërë pa ligj*, është i pabazuar. Kuptimi i masave disiplinore nuk mund të ngushtohet vetëm brenda rasteve të parashikuara në nenin 105 të ligjit nr. 96/2012, pasi një interpretim i tillë do të binte ndesh me nenin 116 të Kushtetutës. Shkronja “Ë” e Aneksit të Kushtetutës ka parashikuar rastet e dhënies së dy masave disiplinore në kuadër të procedurës së rivlerësimit kalimtar të magistratëve, përkatësisht pezullimin nga detyra për një vit dhe shkarkimin nga detyra. Vendimi i KPK-së për shkarkimin nga detyra gëzon statusin e masës disiplinore. Ruajtja e statusit të magistratit, si rrjedhojë e ankimit të vendimit të KPK-së në KPA, nuk do të thotë se vendimi i KPK-së për shkarkimin nuk përbën masë disiplinore në fuqi. Vendimi nr. 75/2019 i KLGJ-së është në përputhje me parashikimet kushtetuese e ligjore dhe rrjedhojë e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit të këtij organi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

17. Gjykata ka pohuar se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, i cili përcakton funksionin themelor të saj, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 9.12.2022; nr. 36, datë 4.11.2021; nr. 29, datë 30.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka theksuar se natyra e pretendimeve të ngritura para saj është një nga elementet përcaktuese të juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e një çështjeje dhe se, në përputhje me kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta, ajo e përcakton vetë juridiksionin e saj gjatë shqyrtimit të çështjeve, rast pas rasti (*shih vendimet nr. 38, datë 9.12.2022; nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata vëren se neni 131, pika 1, shkronja “c”, i Kushtetutës përcakton kompetencat e saj për kontrollin e pajtueshmërisë së akteve normative të



organeve qendrore e vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Po kështu, sipas nenit 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, në raste të veçanta, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe akti normativ, sipas nenit 49, pika 3, shkronja “e”, të këtij ligji.

19. Në objektin e kërkesës kërkuësja ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetuese edhe të pikës 7, seksioni B, kreu X, të vendimit nr. 75/2019 të KLGJ-së. Sipas saj, ky parashikim ka cenuar *rezervën ligjore dhe kufizimin me ligj të të drejtave*, dhe në miratimin e përmbajtjes së këtij rregullimi, KLGJ-ja, në tejkalim të kompetencave, ka përcaktuar një kriter të ri të paparashikuar në ligj, në shkelje të neneve 118 dhe 17 të Kushtetutës. Po sipas kërkuëses, neni 48 i ligjit nr. 96/2016 ka autorizuar KLGJ-në për nxjerrjen e akteve nënligjore vetëm për çështjet e parashikuara në pikën 14 të tij dhe jo për çështje të tjera, për të vendosur kritere të reja ose për interpretim të zgjeruar të tyre.

20. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka prapësuar se vendimi nr. 75/2019 i KLGJ-së është në përputhje me parashikimet kushtetuese e ligjore dhe rrjedhë e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit të këtij organi. Sipas tij, kuptimi i masave disiplinore nuk mund të ngushtohet vetëm brenda rasteve të parashikuara në nenin 105 të ligjit nr. 96/2012, pasi një interpretim i tillë do të binte ndesh me nenin 116 të Kushtetutës. Shkronja “E” e aneksit të Kushtetutës ka parashikuar rastet e dhënies së dy masave disiplinore në kuadër të procedurës së rivlerësimit kalimtar të magistratëve, përkatësisht pezullimin nga detyra për një vit dhe shkarkimin nga detyra. Vendimi i KPK-së për shkarkimin nga detyra gëzon statusin e masës disiplinore. Ruajtja e statusit të magistratit, si rrjedhë e ankimit të vendimit të KPK-së në KPA, nuk do të thotë se vendimi i KPK-së për shkarkimin nuk përbën masë disiplinore në fuqi.

21. Gjykata vlerëson të ndalet fillimisht në fuqinë juridike të pikës 7, seksioni B, kreu X, të vendimit nr. 75/2019 të KLGJ-së, kushtetutshmëria e së cilës kundërshtohet nga kërkuësja, pasi verifikimi i këtij elementi formal lidhet me juridiksionin e vetë Gjykatës dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes prej saj. Lidhur me kontrollin kushtetues të akteve të shfuqizuara, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se, si rregull, normat juridike i nënshtrohen kontrollit kushtetues nëse janë në fuqi në kohën e kontrollit ose, e thënë

ndryshe, nëse janë akte të vlefshme që prodhojnë pasojë juridike (*shih vendimet nr. 38, datë 9.12.2022; nr. 9, datë 19.3.2008, të Gjykatës Kushtetuese*). Përgjithësisht, kontrollit kushtetues i nënshtrohen edhe normat juridike të shfuqizuara, kur këto, si pjesë e së drejtës pozitive, duhet të zbatohen për rregullimin e pasojave juridike që zgjasin në kohë dhe janë të lidhura me ekzekutimin periodik ose me afat të detyrimeve juridike civile që rrjedhin nga marrëdhënie juridike të krijuara në kohën e ligjit të shfuqizuar (*shih vendimet nr. 8, datë 7.2.2017; nr. 2, datë 31.1.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Pika 7, seksioni B, kreu X, e vendimit nr. 75/2019 të KLGJ-së parashikonte: “*Kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe kur ndaj atij vendimi është paraqitur ankim, nuk pranohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin.*”.

23. Gjykata konstaton se kjo pikë është shfuqizuar me vendimin nr. 528, datë 10.11.2021, të KLGJ-së, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 75, datë 23.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”” (*vendimi nr. 528/2021*), i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 177, datë 15.11.2021, për rrjedhë ajo nuk është më pjesë e rendit juridik.

24. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuësja nuk ka paraqitur ndonjë argument kushtetues se në rastin konkret ndodhemi para rasteve përjashtimore që do ta lejonin Gjykatën që këtë akt t’ia nënshtrohte kontrollit kushtetues. Për rrjedhë, në kushtet kur Kreu X i Seksionit B të vendimit nr. 75/2019 të KLGJ-së nuk ka më në përmbajtje të tij pikën 7, të kundërshtuar nga kërkuësja, Gjykata vlerëson se kjo pjesë e kërimit nuk mund të bëhet objekt i kontrollit kushtetues dhe në lidhje me të gjykimi duhet të pushohet.

B. Për legjitimitetin e kërkuësës

25. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1,



shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

26. Gjykata vlerëson se kërkesja legjitimohet *ratione personae*, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, për rrjedhojë provon interesin e saj të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

27. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individit pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese (shih vendimet nr. 12, datë 24.5.2022; nr. 5, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese).

28. Për sa i përket pretendimeve të ngritura në kuadër të procesit gjyqësor, Gjykata, në drejtim të përmbushjes së kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, vëren se pretendimin për cenimin e së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme kërkesja nuk e ka ngritur, si të tillë, në rekursin e saj drejtuar Gjykatës së Lartë, duke mos shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës. Ndërkohë, pretendimet e tjera kërkesja i ka ngritur, në thelb, para gjykatave. Vendimi i Gjykatës së Lartë i kundërshtuar ka përmbyllur procesin gjyqësor për shqyrtimin e themelit të çështjes, për rrjedhojë kërkesja ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës.

29. Kërkesja legjitimohet *ratione temporis*, pasi vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i datës 2.12.2021, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 2.4.2022, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

30. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar se vendimet e KLGJ-së, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Gjykatës së Lartë i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, standardit të arsytimit të vendimit, parimit të sigurisë juridike, si dhe së drejtës së aksesit. Po kështu, ajo ka parashtruar pretendime edhe në lidhje me vendimin e ndërmjetëm nr. 71, datë 17.6.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit, që ka vendosur për kërkesën e saj për përjashtimin e gjyqtarës A.G.

31. Në lidhje me mundësinë e rivendosjes së të drejtës, neni 71/a, pika 1, shkronja “ç”, i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur “*shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të individit*”. Për sa i përket vlerësimit të këtij kriteri në rastin e kërkesës, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

32. Kështu, sipas njërit qëndrim u vlerësua se kërkesja legjitimohet *ratione materiae* në kërkesën drejtuar Gjykatës, pasi pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues bëjnë pjesë në juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës. Në rastin e ankimit kushtetues individual, Gjykata shqyrton pretendimet për gjykimet përfundimtare, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese. Cenimi i të drejtave dhe lirive kushtetuese të individit, në rastet kur ky i fundit është gjyqumbës, i ka shkaktuar dëm real në aspektin e së drejtës ose lirisë së vendosur me gjykimin përfundimtar jo vetëm individit, por njëkohësisht edhe funksionimit normal të shtetit të së drejtës, në situatën kur vendimi gjyqësor i ka dhënë pasojat e tij. Me fjalë të tjera, shqyrtimi kushtetues i akteve të pushtetit



publik, për të cilat janë dhënë vendime gjyqësore përfundimtare, nuk shkakton pamundësi për rivendosjen në vend të të drejtave kushtetuese të shkelura, për rrjedhojë nuk është shkak për mospranimin e ankimit kushtetues individual. Nën këtë analizë, plotësimi i vendeve vakante në Gjykatën e Lartë, për të cilat kërkesja ka kandiduar (për shkak se ankimi gjyqësor i saj nuk u pranua), nuk mund të konsiderohet “pamundësi e rivendosjes në vend të të drejtave kushtetuese të kërkuar nga shqyrtimi i çështjes kushtetuese nga Gjykata”, në kuptim të juridiksionit dhe kompetencës lëndore të saj sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000.¹

33. Sipas qëndrimit tjetër u vlerësua se në zbatim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000, shqyrtimi i çështjes nga Gjykata nuk do të rivendoste në vend të drejtat që kërkesja pretendon se i janë shkelur, pasi dy pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me vendimet nr. 87, datë 26.2.2020 dhe nr. 243, datë 9.7.2020 të KLGJ-së, për të cilat kërkesja ka kandiduar, janë plotësuar përmes dekreteve përkatëse. Një ndër mënyrat se si mund të rivendoset në vend e drejta e pretenduar e cenuar është nëpërmjet vendimmarrjes së Gjykatës për shfuqizimin e vendimeve objekt kundërshtimi si të papajtueshme me Kushtetutën dhe rikthimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën përkatëse ose konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese, duke i “detyruar” organet të veprojnë në mënyrën më efektive për të rivendosur në vend të drejtën kushtetuese. Në këtë këndvështrim, shqyrtimi i pretendimeve të paraqitura nga kërkesja përmes ankimit kushtetues individual dhe, nëse ato do të vlerësoheshin të bazuara, shfuqizimi i vendimeve të kundërshtuara, nuk do të sillte rezultate konkrete në drejtim të rivendosjes në vend të së drejtës së pretenduar të cenuar.²

34. Për sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa e kërkuarës konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 133, pika 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës për kerkimin e parë.
2. Pushimin e gjykimit për shfuqizimin e pikës 7, seksioni B, kreu X, të vendimit nr. 75/2019 të KLGJ-së.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 8.2.2023.

Shpallur më 10.3.2023.

Kryesuese: Marsida Xhaferllari

Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Holta Zaçaj

¹ Votuan për legjitimimin *ratione materiae* të kërkuarës gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja dhe Marjana Semini.

² Votuan për moslegjitimimin *ratione materiae* të kërkuarës gjyqtarët Elsa Toska, Sandër Beci, Genti Ibrahimi dhe Holta Zaçaj.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë